



Prishtinë, 10 shkurt 2012
Kodi i ZRRE-së: V_397_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe 2.17, dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK Sh.A) për derogim (shtyrje afati) në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Shpërndarjes, të datës 17 janar 2012,

në seancën e mbajtur me datë 10 shkurt 2012, nxori këtë:

VENDIM

- I. I LEJOHET** Korporatës Energjetike të Kosovës derogimi (si në Shtojcë të këtij vendimi) në zbatimin e disa neneve dhe dispozitave të Kodit të Shpërndarjes.

Arsyetim

- ZRRE me datë 17.01.2012 ka pranuar (në formë elektronike) kërkesën e ndërmarrjes KEK Sh. a, e cila ka kërkuar shtyrje afati (derogim i zbatimit) të disa dispozitave të Kodit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
 - ZRRE ka analizuar dispozitat dhe arsyetimin e paraqitur në kërkesën e KEK-ut dhe bazuar në dispozitat ligjore të theksuara në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të Kodit të Shpërndarjes mbesin në fuqi.
- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bashkëngjitur Shtojca me derogimet (shtyrje afati) e lejuara me datë 10.02.2012 për KEK sh.a.*

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Enver Halimi, anëtar



Shtojcë: Nenet e deroguara (shtyrje afati) me datë 10.02.2012 të dispozitave Kodit të OSSH

Kodi i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike						
Nr	Neni/Dispozita	Derogimi i datës 10.09.2010 deri me:	Derogimi i datës 30.03.2011 deri me:	Derogimi i datës 28.04.2011 deri me:	Derogimi i datës 10.02.2012 deri me:	Vërejtje nga ZRRE
1.	Dispozita 5.7 Matja/Telematja			31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2012	
	Dispozita 6.4 Komunikimi Operues dhe Veprimi			31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2012	
2.	Dispozita 6.1.4 Humbja e Qendres së Kontrollit	31 dhjetor 2010	31 dhjetor 2011		31 dhjetor 2012	
3.	Dispozita 6.6 Testimi i Sistemit		-	31 dhjetor 2011	31 dhjetor 2012	